



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA VUSHTERRI
OPŠTINA VUČITRN

PROCESVERBAL

nga mbledhja e XIII-të e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 14 dhjetor 2022 në sallën e kuvendit të komunës, e cila filloi në ora 10:10.

Në mbledhje ishin të pranishëm: Melihate Basholli-Latifi (kryesuese), Ilmi Azemi, Nurie Halili, Lorik Maxhuni, Agron Përçuku, Alban Bajrami, Fakete Dushi, Sylejman Mehulli dhe Fatmire Cecelia (anëtarë të KPF -së).

Gjithashtu në këtë mbledhje morën pjesë edhe: Ferit Idrizi (Kryetar i komunës), Shpëtim Zhegrova, (Nënkryetar i komunës), drejtorët e drejtorive, Haki Maloku, nga zyra e kryetarit, si dhe nga sekretaria e kuvendit, Bastri Duraku dhe Bujar Klinaku.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Melihate Basholli-Latifi, kryesuese e kuvendit dhe e KPF-së, e cila konstatoi se ekziston shumica e mjaftueshme për punë.

Ajo tha se na kanë ardhur edhe tri propozime për t'u futur në rend të ditës:

- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për publikimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023;
- Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026;
- Shqyrtimi i kërkesës për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq.

Ajo deklaroi se lidhur me dy propozimet e para, drejtorët e drejtorive do t'i arsyetojnë, kurse lidhur me kërkesën e Kryqit të Kuq – dega në Vushtrri, përveç që kanë nevojë për objekt e dimë të gjithë, por ata më kanë njoftuar se kanë mundësi ta përfitojnë një donacion nga Kryqi i Kuq i Kosovës në vlerë prej 30 mijë euro për ndërtimin e objektit. Afati i fundit për miratim të kësaj kërkesë është seanca e dhjetorit. Lidhur me këtë, drejtoritë përkatëse do ta shqyrtojnë kërkesën dhe për kuvend do të vijnë me një propozim.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – kërkoi që pika gjashtë e rendit të ditës < Shqyrtimi i Draft – Rregullore për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë > të hiqet krejt nga rendi i ditës, për arsye se kuvendi i komunës e ka formuar një komision dhe të nesërmen veç ka dalë në webfaqe të komunës një draft – rregullore. Ai tha se komisioni ende nuk është konstituuar dhe nuk e dimë as kush është kryesues. Pra, siç po shihet kjo draft – rregullore është hartuar prej dikujt nga drejtoritë komunale. Ky draft është hartuar në mënyrë joprofesionale dhe nuk përkon me nevojat dhe kërkesat e qytetarëve e as të bizneseve. Prandaj, për këtë rregullore të rëndësishme duhet kohë më shumë dhe të organizohet diskutim publik me biznese dhe qytetarë, tha ai.

Kurse, pikat shtesë që kanë ardhur, nuk janë të natyrës urgjente. Lidhur me kërkesën e Kryqit të Kuq, ne e kemi trajtuar dhe është marrë vendim nga kuvendi për këtë, por s'po e di saktë se kur ka qenë. Prandaj, të hulumtohet se si qëndron çështja me vendimin e kaluar, tha ai.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – tha se për çdo mbledhje po na vijnë pika shitesë në mbledhje dhe s'po vijnë me kohë. Prandaj, nuk është mirë që po vazhdon kjo praktikë. Prandaj, po na detyroni me votu pa material fare. E mirëkuptoj kërkesën e Kryqit të Kuq dhe arsyetimin tuaj që është e natyrës urgjente, por dy pikat tjera nuk e di pse duhet të votojmë kur nuk ka material. Prandaj, mirë do të ishte të na vjen materiali me kohë që ta analizojmë, sepse po na detyroni të votojmë pa asnjë material, pa e ditur se çka po votohet. Lidhur me Kryqin e Kuq është diskutuar në kuvend, por nuk e di saktë se a është marrë vendim apo jo. Unë jam kundër që pikat shitesë të hyjnë në rend të ditës, me përjashtim të pikës për Kryqin e Kuq.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – lidhur me Kryqin e Kuq, e di që ka një vendim i mëhershëm i kuvendit. Kurse, lidhur me Draft – Rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë edhe unë pajtohet që t'i nënshtrohet një diskutimi më të gjerë. Për shkak se rregullorja e mëhershme i ka pasur disa zbrazëtira, prandaj e kemi kthyer në ridraftim. Komisioni ka punuar dhe e ka hartuar këtë draft, por për shkak se është rregullore e rëndësishme, duhet të diskutohet më gjerësisht me bizneset, qytetarët dhe grupet tjera të interesit, prandaj edhe unë po kërkoj që të hiqet nga rendi i ditës. Idrizi kërkoi aprovimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023, sepse kjo është vetëm lista që duhet të publikohet, sepse nuk kemi me dhënë në shfrytëzim në këtë fazë.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë e sqaroi kryetari i komunës se lista për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023 është vetëm lista që duhet të publikohet në faqen e komunës, kurse dhënia në shfrytëzim e pronave më vonë ipet në shfrytëzim, duke i respektuar procedurat.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – lidhur me listën e pronave në shfrytëzim, u sqarua që bëhet fjalë vetëm me publikimin e listës së pronave që priten të ipen në shfrytëzim gjatë vitit 2023. Prandaj, edhe emërtimi le të jetë i qartë dhe të ndryshohet, tha ai.

Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se komuna e ka caktuar një ekip, të cilët e kanë hartuar këtë draft – plan, i cili përfshin periudhën 2022 – 2026, i cili do të ketë ndikime pozitive në ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit në tërë territorin e komunës sonë. Ajo tha se projektet, të cilat do t'i realizojë komuna do të kenë në qendër mjedisin e pastërt. Ajo deklaroi se, drafti gjendet ende në diskutim publik. Prandaj, ajo kërkoi që të procedohet në kuvend, se aprovimi i këtij plani nënkupton edhe marrjen e granteve.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se materialin e kemi të gatshëm dhe posa të shtohen si pika të rendit të ditës, do të shpërndahet materiali.

Bujar Pllana, drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – tha se po flet në cilësinë e komisionit lidhur me draft rregulloren për bizneset. Rregulloret e mëhershme kanë qenë gjysmake, sepse ka pasur biznese që nuk kanë qenë të përfshira në rregullore. Ai deklaroi se kjo rregullore është shumë më profesionale se rregulloret e mëhershme. Ai deklaroi se diskutimi publik është planifikuar që të mbahet, por nuk ka pasur të interesuar që të marrin pjesë në atë takim.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – përderisa u tha se ka material për pikat shtesë, ai kërkoi që të shpërndahet materiali dhe ta dimë se çka po votojmë. Pra, drejtorët e drejtorive të na japin sqarime konkrete se çka përmbajnë këto pika. Si dhe kur t'i votojmë pikat shtesë, t'i votojmë një nga një, e jo në bllok.

Haki Maloku, anëtar i komisionit – tha se Draft – Rregulloren për Fillimin dhe Mbarimin e Orarit të Punës së Veprimtarive Afariste – Bizneseve në Komunën e Vushtrrisë e ka hartuar komisioni i themeluar nga kryetari i komunës në mënyrë profesionale dhe të bazuar në legjislacionin në fuqi. Kjo draft – rregullore gjendet në konsultim publik dhe kushdo që ka plotësime, mund t'i japë komentet derisa të kryhet afati i konsultimit. Prandaj, nuk mendoj që ka arsye të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës. Ai tha se në konsultimin publik që ka qenë i planifikuar nuk ka pasur pjesëmarrës, por është inicuar procedura për thirrjen e bizneseve ku është caktuar data e takimit, për ti paraqitur komentet e tyre.

Ergin Sunguri, drejtor i Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – kërkoi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, për shkak se duhet të bëhen edhe disa ndryshime dhe të punohet më shumë në këtë drejtim.

Bastri Duraku, sekretaria e kuvendit – lidhur me kërkesën e Kryqit të Kuq, dua të ju informoj se më datë 26.11.2020 është marrë vendimi për këtë çështje, por MAPL ja ka proceduar lëndën Ministrisë së Mjedisit, e cila ka vlerësuar se vendimi nuk është në përputhje me legjislacionin në fuqi, për shkak se vendimi nuk është bazuar në Ligjin për Planifikim Hapësinor, Planin Zhvillimor Komunal. Po ashtu, është thënë se nuk lejohet destinim tjetër apo shfrytëzueshmëri tjetër nga ajo që është paraparë me dokumente të planifikimit strategjik hapësinor.

Prandaj, ky vendim duhet edhe një herë të rivotohet për shkak se i ai i mëhershmi nuk është në fuqi.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se nuk është praktikë e mirë të sjellen pika pa materiale dhe të votohet diçka e tillë. Mund të thirrni edhe mbledhje tjetër të KPF-së dhe përgatitet materiali, tha ai. Nuk jemi që t'i kundërshtojmë, por duhet kohë që t'i analizojmë.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF-së – theksoi se për shkak të performancës së mirë të komunës, këto pika duhet të shqyrtohen në KPF dhe të procedohen në kuvend, sepse ka kohë deri atëherë të analizohen.

Shpëtim Zhegrova, nënkryetar i komunës – deklaroi se e di që nuk është praktikë e mirë që të vijnë pikat gjatë takimit, por duhet të merret parasysh një gjë që, KPF-ja është një filter që i trajton materialet para mbledhjes së kuvendit. Konsideroj se ka vend që të diskutohet për këto pika të rendit të ditës. Prandaj, deri në kuvend ka kohë që të analizohen, por për shkak të natyrës urgjente, me qëllim të ngritjes së performancës komunale, sot janë sjellë në mbledhje këto materiale, tha ai.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se nuk është faji i anëtarëve të KPF-së, sepse materialet është dashur të vijnë me kohë. Lista e pronave duhet të riformulohet. Lidhur me draft – rregulloren për biznese, ai përsëri kërkoi që të shtyhet për shkak që palëve të interesit t'iu ipet hapësirë për t'i paraqitur komentet e tyre. Sepse, mos të merret vetëm afati formal se drafti ka

qenë në diskutim publik dhe nuk ka marrë pjesë askush. Puna kryhet kur aktet relevant paraqesin sugjerimet e tyre.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – pikat tjera u sqaruan, kurse për mua ka mbetur e pa sqaruar lokacioni për Kryqin e Kuq, se ku gjendet.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – parcela që ka qenë e votuar është pronë e AKP-së dhe atë nuk e sjelli për t'iu sfiduar. Prandaj, esenca është deri të procedohet në kuvend dhe deri atëherë të shikohet mundësia për gjetjen e një lokacioni, tha ai.

Komiteti për Politikë dhe Financa me shtatë (7) vota “për”, dy (2) “kundër”, e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Propozim – vendimit për publikimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023>.

Komiteti për Politikë dhe Financa me shtatë (7) vota “për”, një (1) “kundër”, një (1) “abstenim”, e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026>.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri e futi në rend të ditës <Shqyrtimin e kërkesës për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq>.

Komiteti për Politikë dhe Financa, me shtatë (7) vota “për”, dy (2) “kundër”, aprovoi këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11.11.2022;
2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023;
3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023;
4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë;
5. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020;
6. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturave në Komunën e Vushtrrisë;
7. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtri;
8. Shqyrtimi i Nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt;
9. Shqyrtimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022;
10. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë;
11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për publikimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023;

12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrisë 2022 – 2026;
13. Shqyrtimi i kërkesës për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq;
14. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 11.11.2022.

Komiteti për Politikë dhe Financa njëzëri aprovoi procesverbalin e datës 11.11.2022.

2. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se komisioni i formuar nga kuvendi në bashkëpunim me sekretarinë e kuvendit e kanë hartuar këtë draft – plan, i cili gjendet në diskutim publik deri më 26 dhjetor 2022. Ne si komision kemi pasur edhe një takim me qytetarë lidhur me këtë. Po ashtu, drejtorët e drejtorive dhe anëtarët e kuvendit e kanë këtë draft – plan në postat e tyre elektronike dhe deri më datën 26 dhjetor t'i japin komentet e tyre, sepse deri më tani nuk kemi asnjë koment.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se në faqën 9, muaji prill, pika 5 është cekur vetëm “Përparimi”. Të ceket se çfarë aktiviteti do të jetë, u shpreh ai.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se deri në seancën e kuvendi do të sqarohet se çfarë aktiviteti do të jetë për ndërmarrjen “Përparimi”.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

3. Shqyrtimi i Draft – Planit të Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2023.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kjo është një çështje që i takon kryetarit të komunës, sepse e paraqet planin e vet për vitin 2023. Në këtë plan është pasqyruar puna e drejtorive dhe e zyrës së kryetarit. Por, kishte me qenë mirë që për seancë të kuvendit të plotësohet me informata se sa janë realizuar objektivat e vitit paraprak. Si dhe cilat janë synimet e kryetarit – objektivat për vitin 2023.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – pajtohem se përmes një parahyrjeje në vija të trasha do të paraqiten objektivat kryesore për vitin 2023.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

4. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridikë – OJQ dhe Ndhmë Momentale Personave Fizikë.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – kërkoi që subvencionimi i qirasë të jetë minimumi 200 euro, e jo 100 euro, për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike – sociale dhe rritjes së inflacionit.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

5. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Bursave për Studentë, Nxënës dhe Shpërblime për Nxënës nr. 45/20 e datës 28.5.2020.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – tha se viteve të fundit është ndryshuar 2-3 herë kjo draft – rregullore. Ai kërkoi sqarime se çka është ndryshuar në këtë draft?

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se e kemi rritur numrin e bursave nga 50 sa kanë qenë në vitin 2021, në 70 vitin 2022. Ai tha se pengesë për ndarjen e bursave ka qenë vet rregullorja, për shkak të notës mesatare. Sa më shumë bursa, nota mesatare vjen duke u zbritur.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

6. Shqyrtimi i Draft – Rregullores për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

7. Shqyrtimi i Propozim – Vendimit për caktimin e lartësisë së pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtrri.

Sylejman Meholli, anëtar i KPF-së – kërkoi që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës së paku deri të miratohet dhe të hyjë në fuqi Ligji i Pagave. Kjo për shkak se në këtë krizë financiare, rritja e pagesës do t’i ngarkojë financiarisht prindërit që i kanë fëmijë në çerdhe.

Propozim i imi është që të rritet subvencionimi ndaj këtyre institucioneve, rritjen e buxhetit për kontratat e furnizimit për këto institucione, për gjëra ushqimore, higjienike, inventarë etj.

Meholli tha se është befasuar për të mirë nga përkushtimi i edukatoreve në çerdhe publike.

Prandaj, ne si subjekt me orientim social - demokrat, në këtë fazë e kundërshtojmë ngritjen e pagesës për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtrri.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – e përkrahu propozimin që në këtë fazë mos të ngritet pagesa për fëmijë parashkollorë në çerdhen e fëmijëve “Foleja” në Vushtrri.

Ilmi Azemi, anëtar i KPF-së – deklaroi se ky propozim duhet të analizohet më gjerësisht, sepse kemi të bëjmë me një konkurrencë që iu bëhet çerdheve private. Për mendimin tim, kjo është një konkurrencë e padrejtë dhe e pandershme, për arsye se komuna i subvencionon çerdhet publike, kurse ato private janë në një gjendje të rëndë dhe për këtë arsye çmimi i tyre është më i lartë se në institucionet publike. Ai tha se ka pasur kontakte me disa pronarë të çerdheve private, të cilët kanë pasur ankesa në këtë drejtim se janë të pabarabartë në treg. E kam të qartë që edhe parafolësit e kanë ndjenjën se qysh me mbajtë çmimin sa më të përballueshëm për ata që i

dërgojnë fëmijë në çerdhet publike. Por, është një ndryshim i madh i çmimit në mes çerdheve publike dhe atyre private.

Prandaj, unë konsideroj që përveç çerdheve publike, duhet të gjendet mundësia që të subvencionohen edhe ato private.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – deklaroi se duhet të bëjmë më shumë për çerdhet publike, t’iu ofrohen kushte më të mira për kryerjen e shërbimeve. Sa i përket shumës financiare, mendoj se është një disproporcion me çerdhet private. Në çerdhet private zakonisht i dërgojnë fëmijë prindërit që kanë një standard më të lartë ekonomik.

Ajo tha se nëse pagesa për një fëmijë bëhet 50 euro, për dy fëmijë 40 euro, atëherë unë propozoj që për fëmijun e tretë të ketë një përqindje më të vogël të pagesës, kurse fëmiju i katërt (raste më të rralla) të jetë pa pagesë.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – deklaroi se nuk është koha e duhur në këtë seancë për rritjen e çmimit. Sa i përket çerdheve private, ato kanë disproporcion edhe në mes vete.

Prandaj, për këtë fazë edhe unë pajtohem që të mos rritet çmimi i pagesës.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – theksoi se duhet ta ruajmë balancën në mes sektorit publik dhe atij privat. Lidhur me investimet në çerdhe, ne e kemi miratuar buxhetin për vitin 2023 dhe aty janë planifikuar investime rreth 150 mijë euro në çerdhe.

Prandaj, është në vullnetin e juaj që ta votoni apo mos ta votoni, por nëse pajtoheni mund ta shtyjmë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me katër (4) vota “për”, tri (3) “kundër” dhe dy (2) “abstenime”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

8. Shqyrtimi i Nismës për bashkëpunim ndërkomunal në mes të Komunës së Vushtrrisë, Mitrovicës dhe Skënderajt.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – deklaroi se është një nismë e bashkëpunimit ndërkomunal me mbështetjen e GIZ-it gjerman, e cila ka të bëjë me avancimin e menaxhimit të mbeturinave në nivel regjional.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

9. Shqyrtimi i Raportit për zbatimin e Planit të Integritetit për vitin 2022.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me pesë (5) vota “për”, asnjë “kundër” dhe tri (3) “abstenime”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

10. Shqyrtimi i Informatës për shërbimet sociale dhe të asistencës në Komunën e Vushtrrisë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – dua të ndalem tek faqja 9, ku vazhdimisht kanë qenë disa kërkesa edhe unë sa kam qenë drejtor. Vështirë kanë qenë të realizueshme, por njëra prej tyre nuk besoj që ka qenë e vështirë të realizohet. Bëhet fjalë për sigurimin e një apo dy veturave

për QPS dhe se si komunë mund të realizohet kjo për kryerjen e shërbimeve. Kurse, sa u përket kujdestarive, kjo besoj do të rregullohet me Ligj të Pagave.

Nexhmedin Rashica, drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale – deklaroi se ka kohë që është inicuar kërkesa për vetura, por është zvarritur procedura e prokurimit në AQP. Shpresojmë që të realizohet kjo sa më shpejtë.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja njëzëri rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

11. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për publikimin e listës për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës për vitin 2023.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se gjatë hartimit nga juristët në drejtori, është bërë gabim teknik tek emërtimi. Por, ai sqaroi se pas aprovimit në kuvend, është obligim ligjor që kjo listë të publikohet në faqen zyrtare. Pastaj, të interesuarit mund të bëjnë kërkesë për marrjen e pronave në shfrytëzim dhe komisioni i zhvillon procedurat për dhënien në shfrytëzim.

Agron Përçuku, anëtar i KPF-së – pyeti se a është bërë verifikimi i pronave se a janë të lira, a ka prej tyre që janë të urupuara?

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – tha se votova kundër procedurës së kësaj pike e jo kundër përmbajtjes. Nëse pronat janë të lira dhe ka të interesuar, komuna duhet ta trajtojë më seriozisht këtë çështje dhe t’iu japë në shfrytëzim të interesuarve, sepse kjo është një mundësi reale me gjeneruar vende të punës, por edhe me sjell investitorë, të cilët janë të gatshëm të investojnë dhe të hapin biznese.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – deklaroi se deri më tani nuk kemi informacione nëse pronat janë të uzurpuara.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me shtatë (7) vota “për”, një (1) “kundër” dhe një (1) “abstenim”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

12. Shqyrtimi i Propozim – vendimit për aprovim të Planit Lokal për Veprim në Mjedis për Komunën e Vushtrrisë 2022 – 2026.

Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se e thashë edhe më herët që komuna e ka caktuar një ekip, të cilët e kanë hartuar këtë draft – plan, i cili përfshin periudhën 2022 – 2026, i cili do të ketë ndikime pozitive në ruajtjen dhe zhvillimin e mjedisit në tërë territorin e komunës sonë. Ajo tha se drafti gjendet ende në diskutim publik. Prandaj, ajo kërkoi që të procedohet në kuvend, se aprovimi i këtij plani nënkupton edhe marrjen e granteve.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se e pashë në këtë plan se janë dy çerdhe publike, ku njëra prej tyre i ka të shënuara 174 fëmijë, kurse tjetra 113 fëmijë. Ky nuk është numër real i fëmijëve në këto dy çerdhe, sepse tek “Foleja 2” ka më shumë fëmijë se sa te “Foleja 1”. Kurse,

në këtë plan është thënë se ekziston vetëm një çerdhe private. Sa unë kam informacion ekzistojnë 6 çerdhe private, katër prej tyre janë të licencuara, kurse tjerat janë në procedurë të licencimit, e njëra prej tyre në procedurë të rilicencimit.

Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – deklaroi se me siguri Drejtoria për Arsim nuk i ka përditësuar të dhënat lidhur me çerdhet.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kërkoi që të rritet numri i inspektorëve nëse është e mundshme. Kurse, qytetarët e pandërgjegjshëm që i dëmtojnë projektet e komunës ose institucionet publike të merren masa ndaj tyre. Në këtë aspekt, jemi ndër komunat me gjendjen më të keqe.

Pas debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, KPF-ja me tetë (8) vota “për”, një (1) “kundër”, rekomandoi që të procedohet për kuvend të komunës në mbledhjen e radhës për shqyrtim.

13. Shqyrtimi i kërkesës për caktim të lokacionit për ndërtimin e objektit të Kryqit të Kuq.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se Kryqi i Kuq i Kosovës – dega në Vushtri ka paraqitur një kërkesë, ku kanë përmendur dy lokacione, të cilat janë të mundshme sipas tyre. Ajo propozoi që kjo kërkesë të shqyrtohet nga drejtoritë përkatëse dhe në kuvend të na vjen propozimi së bashku me lokacionin/et.

Remzi Ahmeti, drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë – tha se do ta shqyrtojnë kërkesën në fjalë dhe do të shikojmë mundësinë e ofrimit të ndonjë lokacioni.

Fortuna Krasniqi Spahiu, drejtoreshë e Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit – theksoi se është në dijeni për këtë kërkesë, por do ta analizojmë dhe do ta shikojmë mundësinë për ndonjë lokacion. Si alternativë, ajo tha se është një lokacion tek “QMF 1”, por do ta shohim deri në kuvend.

14. Të ndryshme.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – tha se prita që do të ketë edhe një pikë shtesë, për një kërkesë për përkrahje financiare për një fëmijë me nevoja të veçanta, i cili është duke qëndruar në kopshtin “Foleja 2”. Ata më kanë thënë që kanë bërë kërkesë për kuvend, prandaj ajo pyeti lidhur me këtë kërkesë, sepse siç kam informacione familja qëndron keq materialisht dhe nëse ka mundësi t’iu ndihmohet.

Melihate Basholli - Latifi, kryesuese e KK-së dhe e KPF- së – theksoi se e ka pranuar një kërkesë të tillë dhe e kemi analizuar dhe si rast më ka prekur shpirtërisht. Por, për shkak se kuvendi nuk po ndan mjete të tilla, ne e kemi proceduar në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.

Fatmire Cecelia, anëtare e KPF-së – deklaroi se nuk mund të thuhet që kuvendi s’po ndan mjete financiare, sepse në seancën e kaluar na ka ardhë kërkesa për përkrahje financiare për klubin e hendbollit. Unë vetëm kërkova sqarim se ku ka mbetur kërkesa në fjalë.

Ferit Idrizi, Kryetar i komunës – tha se rregullorja për subvencione është në proces të plotësimit – ndryshimit, prandaj mos të bëhen kufizime, sepse të gjithë kemi vullnet t’iu ndihmojmë, por rregullorja po na kufizon. Ai tha se jam që t’i përkrahu këto raste, por vetëm ta gjejmë mënyrën se si t’iu ndihmojmë.

Sylejman Mehulli, anëtar i KPF-së – kërkoi që kur të trajtohen rastet e tilla, të ruhet fshehtësia e diganozës.

Mbledhja përfundoi në orën **12:00**.

Bujar Klinaku


Procesmbajtës

Melihate Basholli - Latifi


Kryesuese e KK-së dhe e KPF- së

